



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

27 Tetor 2023

DEKLARATË PËR SHTYP

NGJARJE E RËNDË NË BURGUN E DRENOVËS

Para disa ditëve, I.J që është duke ekzekutuar dënimin me burg në burgun e Drenovës i është drejtuar Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) me ankesën si vijon:

- a) Ndaj meje është marrë një masë e padrejtë. Është vendosur masa e mbikëqyrjes së veçantë për tre muaj.
- b) Më kanë lidhur në krevat me pranga dhe zinxhirë 6 ditë. I kam të shënuara dhe oraret.

KShH për verifikimin e kësaj ankese, më datë 19.10.2023 ngarkoi një grup vëzhguesish, në përbërjen e të cilit edhe një mjek.

Lidhur me ankesën e parë:

Sipas raportit të incidentit datë 31.08.2023, i dënuari I. J ka goditur me grusht një të dënuar tjetër. Për këtë shkak, ai u çua në dhomën e izolimit. Pas ndjekjes së procedurave përkatëse, me vendimin datë 13.09.2023, Komisioni i Vlerësimit të të dënuarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në bazë të nenit 68/1 gërma “a” të ligjit nr. 81/2020 vendosi: “Kalimin e të dënuarit I.V në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, për një periudhë 3 mujore që fillon nga data 31.08.2023 ora 12:30”

Në nenin 68 pika 1 shkronja “a” të ligjit 81/2020 thuhet: “*I burgosuri mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes të veçantë për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj, kur rrezikon sigurimin e personelit të institucionit, ose kur ka rrezik të dëmtojë veten ose të tjerët*”. Në fakt, në Raportin e incidentit që përmendëm më lart, nuk behet fjalë as për rrezikun e sigurisë së personelit të institucionit dhe as për rrezikun e dëmtimit të vetes, apo të tjerëve.

Prandaj vendimi i marrë kundër I.J është i kundër ligjshëm dhe arbitrar. Ndaj tij mund të merrej një masë tjetër disiplinore dhe e përshtatshme aq më tepër kur, sipas kartelës mjekësore ai vuan nga “çrregullime të personalitetit kufitar” dhe mjekohet me ilaçe qetësues dhe antidepresivë. Madje para marrjes së kësaj mase dhe gjatë ekzekutimi të saj, ai duhej t’i nënshtrohej vizitës mjekësore për të konstatuar gjendjen e tij shëndetësorë dhe nëse ai e përballonte ose jo një masë të tillë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Lidhur me ankesën e dytë:

Në takimin që grupi monitorimit pati me të dënuarin I. J ai deklaroi se është mbajtur në krevat i lidhur me zinxhirë dhe pranga fikse 4,6, 24 dhe 48 orë. Shtetasi i pohoi vëzhguesve se nga dëshpërimi, shqetësimi dhe trajtimi i keq, ka ngrënë copa xhami. Staf i IEVP lejoj ekipin e vëzhguesve që të shikonte në kolonë (vendi ku qëndrojnë punonjësit e policisë gjatë kryerjes së shërbimit) të varur në mur, dy pranga fikse me ngjyrë të zezë, të cilat kishin pjesën që izolon dorën dhe një krah deri 25 centimetra, një zinxhir dhe në një kthinë, një skafandër të zezë, mbi të cilën kishin mbetur vetëm gërmat "...ICIA", që dukej se ishte një skafandër e policisë. I.J i pohoi vëzhguesve të KShH-së, se këto ishin mjetet me të cilat ishte mbajtur i lidhur.

Lidhjen e të dënuarit me zinxhirë e pohuan mjeku, Drejtori dhe përgjegjësi i edukimit të IEVP-së, duke e justifikuar si masë parandaluese që të mos dëmtonte veten¹, por mohuan që ai të jetë mbajtur i lidhur për 6 ditë. Për këtë veprim nuk dispononin asnjë dokument (Procesverbal). Madje mjeku paraprakisht nuk ishte vënë në dijeni për këtë masë, as që e kishte vizituar, madje i pyetur nga grupi monitorues i KSHH-së ai pohoi se e kishte parë I.J të lidhur në krevat.

Referuar të dhënave të monitorimit, KShH vlerëson se akte të tilla tepër të rënda, të padokumentuara, të kundërligjshme e që bien ndesh me standartet ndërkombëtare të cituara në vijim të deklaratës, krijojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara se prangosja dhe lidhja me zinxhirë e këtij shtetasi, në gjendjen shëndetësore mentale të tij dhe për një kohë të gjatë, ka bërë që I.J ti nënshtrohet trajtimit me elementë ç'njerëzore dhe degradues në ambientet e izolimit të IEVP Drenovë.

Në çështjen *Kucheruk kundër Ukrainës*, Gjykata e Strasburgut konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ndalimi i torturës), ndaj një të paraburgosuri që vuante nga skizofrenia kronike, i cili u ankua ndër të tjerash se ishte mbajtur i prangosur në izolim. GJEDNJ u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës) të Konventës Evropiane (KEDNJ), duke konstatuar veçanërisht se mbajtja me pranga të një shtetasi me sëmundje mendore, për një periudhë prej shtatë ditësh, pa një opinion të justifikuar psikiatrik dhe kujdes mjekësor, duhej të konsiderohej si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar. Për më tepër, vetë izolimi dhe prangosja e kërkuesit nxori në pah që autoritetet vendase nuk kishin ofruar trajtimin e duhur mjekësor dhe ndihmë për të².

¹ Mjeku pohoi se lidhja ishte bërë me pranga pasi i burgosuri kishte thyer xhamin e dritares me kokë dhe rrezikoi jetën.

² https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/fs_detention_mental_health_eng, fq.2



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në raportin e vitit 2017 për Shqipërinë, Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) ka rekomanduar heqjen e prangave të dorës dhe kyçit të këmbës në Qendrën Spitalore të Burgjeve dhe I EVP Krujë, duke i zëvendësuar ato menjëherë pajisje frenuese (shtrënguese) profesionale të njohura (mundësisht, rripa pëlhure të mbushura) për të minimizuar rrezikun e lëndimit dhe/ose vuajtjen nga dhimbja të pacientit³. Në raportin e vitit 2018 të KPT, për një shtetas që nuk vuan nga sëmundje e shëndetit mendor (i huaj që mbahej në Qendrën e Kareçit), KPT ka nënvizuar se personi në fjalë nuk duhet të prangoset në objekte fikse (si shtrati), por në vend të kësaj të mbahet nën mbikëqyrje të ngushtë në një mjedis të sigurt dhe, nëse është e nevojshme, duhet të sigurohet ndihmë mjekësore. Ky veprimet sipas KPT, duhet të dokumentohet në regjistër⁴.

Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit nuk duhet të tejkalojë kufizimet e vendosura në neni 71 pika 2 e ligjit 81/2020. Në Rregulloren e Përgjithshme të burgjeve thuhet gjithashtu se ndalohet përdorimi i forcës për qëllime të torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Prangat mund të përdoren nëse janë të domosdoshme për të parandaluar një sjellje të dhunshme, ose kur i burgosuri bën përpjekje për tu arratisur (neni 96 pika 5 e Rregullores) se “Izolimi në një dhomë të veçantë si mjet kufizimi i përkohshëm përdoret vetëm përjashtimisht dhe jo më tepër se 24 orë. (neni 96, pika 7 e Rregullores). Përveç cenimit të këtyre dispozitave, KShH vëren me shqetësim se I.J është lidhur me zinxhirë dhe pranga pa marrë mendimin e mjekut të Institucionit, çka bie ndesh me pikën 9 të nenit 96 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve⁵.

Të bindur për shkeljen e rëndë të standarteve ndërkombëtare të detyrueshme për Shqipërinë si dhe legjislacionit vendas, KSHH i sugjeron Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që jo vetëm ta hetojë administrativisht këtë rast, dhe në varësi të rezultateve të hetimit të zbatojë kërkesën e nenit 96 pika 10 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve ku thuhet **“Në rastet e tejkallimit të masës të përdorimit të forcës nga ana e personelit të institucionit, ndaj tyre veprohet në përputhje në dispozitat ligjore në fuqi.**

E shikojmë të nevojshme t’u sugjerojmë gjithashtu se shkeljet ligjore të përmendura më lart në I EVP-në e Burgut të Drenovës kërkojnë marrjen e masave përkatëse me natyrë parandaluese në të gjitha institucionet e tjera të ekzekutimit të vendimeve penale, duke dërguar pranë tyre qarkore që japin udhëzimet e nevojshme për përdorimin e mjeteve shtrënguese, në përputhje me standardet ndërkombëtare, dispozitat e ligjit 81/2020 si dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

³ <https://rm.coe.int/16808ae48f>, fq.21

⁴ <https://rm.coe.int/168097986b>, fq.26

⁵ Në rast vetëdëmtimit të burgosurit institucioni përdor masa të veçanta të kufizimit fizik, por “Për vendosjen apo kohëzgjatjen e kufizimit fizik merret në çdo rast mendimi i mjekut të institucionit. Mjeku vlerësoi nëse përdorimi i mjeteve kufizuese duhet të vazhdojë ose jo dhe dokumenton rastin në kartelën klinike...”